

Debat publik mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së

Split, Kroaci

26 nëntor 2009

Shoqata e Akademisë Kroate në Split, organizoi Debat publik lidhur me themelimin e KOMRA-së, në të cilin morën pjesë 44 pjesëmarrës – aktivistë të organizatave për të drejtat e njeriut, gazetarë, përfaqësues të Bashkësisë së Akademisë, dhe të Kishës Katolike, gazetarë dhe qytetarë. Fjalën hyrëse e mbajtën Vesna Teršelić dhe Eugen Jakovčić (Documenta, Zagreb, Kroaci) dhe Suzana Kunac (B.a.b.e., Zagreb, Kroaci). Debatin e moderoi don Ivan Grubišić (Shoqata e Akademisë Kroate, Split, Kroaci.)

Shqyrtimi i propozimeve, rekomandimet dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:

Dokumentet zhduken, dëshmitarët vdesin, ndërsa ne akoma nuk kemi bazën e të dhënave.

Duke punuar ne hulumtimin e krimeve të luftës në Bosnjë e Hercegovinë, kam parë se sa është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm themelimi i kësaj Initiative. Kur për herë të parë kam tentuar të gjej dokumente për krimet e luftës, (...) kur kam filluar të hulumtoj të gjej dokumentet e para zyrtare, më kanë pritë me neveri, mosbesim. Sikur donin të thonin: ky tani po i kërkon të dhënat për krimet e luftës që i kanë bërë Myslimanët ndaj Kroatëve, por çfarë nëse fillon të kërkojë edhe tjera? (...) Ato arkiva për luftën në Bosnjë e Hercegovinë janë të shpërndara nëpër tërë botën, gjithashtu edhe dokumentet për krimet e luftës. Tri herë kam qenë në Arkivin shtetërorë të Kroacisë dhe i kam kontrolluar të gjitha dokumentet me emrin - Lufta në Bosnjë e Hercegovinë. Në 74 arka. Dhe, tani mund t'u them se disa dokumente të cilat i kam gjetur herën e parë, në herën e dytë ato nuk kanë qenë aty... Andaj, dokumentet zhduken. Dëshmitarët vdesin, ndërsa ne nuk e kemi bazën e të dhënave, ku mund ti gjejmë ato. (Ivica Mlinovčić, gazetarë, Split, Kroaci, Debat publik mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Split, Kroaci, 26 nëntor 2009)

Në këtë Iniciativë, Kisha do të duhej të jetë në radhën e parë, por ajo i mbyllë sytë para të vërtetës. Ata besojnë se e kanë të vërtetën absolute, dhe se nuk kanë nevojë për dialog.

Ne, në Këshillin e Shoqatës, ku e respektojmë të drejtën procedurale, do të diskutojmë lidhur me inkuadrimitonë në Koalicionin për KOMRA-në. Por, sigurisht që jemi për vërtetimin e fakteve, dhe sigurisht, aq sa mundemi, do të ndihmojmë në këtë çështje. Unë mendoj se në këto çështje, Kisha do të duhej të jetë në radhët e para, por ekzistojnë një varg arsyesimesh të tyre të cilat në fakt janë utopike, ose mbyllja e syve para të vërtetës. Frikohem, dhe do të dëshiroja të jem gabim, se ajo do të silltë kështu edhe lidhur me qëndrimet më të reja, që në shoqërinë tonë, pas

19 vitesh, se do të duhet të zbatohet lustrimi, dhe se presidenti i ardhshëm do të duhej të marrë qëndrim ekspllicit për viktimat e komunizmit dhe ti dënojë. (...)Problemi qëndron në atë nëse nuk jemi të gjithë nën të njëjtën ombrellë, ku ata do të kontrollojnë, mbikëqyrin apo përcaktojnë. I tillë është mentaliteti, dhe unë mendoj se madje është diapazoni dhe niveli i të menduarit. (...) Ata të cilët besojnë se e kanë të vërtetën absolute, atyre nuk u duhet dialogu. Dhe ky është problemi i të menduarit sipas atij mentaliteti, ndërsa unë mendoj se vetëdijesimi qytetar ngadalë po zhvillohet, dhe se duhet pasur durim. Unë personalisht, me kënaqësi inkuadrohem në programet të cilat kanë për detyrë të çojnë përpara Mosor-in. Kjo gjë mua më sfidon. Mendoj se shtyrja para e këtij projekti njëkohësisht është shtyrje para e Mosorit. (Don Ivan Grubišić, Shoqata e Akademisë Kroate në Split, Debat publik mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Split, Kroaci, 26 nëntor 2009)